


INSTITUTI EPIK

PRILL 2019

MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT (MSA)



Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) hyri në fuqi më 1 prill 2016. MSA ka vulosur orientimin strategjik të Kosovës për t'u anëtarësuar në BE dhe ka krijuar kornizën formale dhe kontraktuale për të arritur këtë qëllim.

Ne aspektin politik, MSA ka vendosur kornizën ligjore të bashkëpunimit brenda së cilës Kosova duhet të përafrojë dhe zbatoj legjislacionin e BE-së. Ndërsa në aspektin ekonomik, MSA-ja ka paraparë kalendarin kohor brenda së cilit do të bëhet liberalizimi i plotë i tregut ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Rëndësia e MSA-së pasqyrohet më së miri në faktin që BE-ja dhe Kosova nuk do nënshkruajnë më asnjë marrëveshje deri në Traktatin e Anëtarësimit.

MSA në 600 faqe, X tituj, 7 shtojca dhe 5 protokolle, rregullon pothuajse çdo aspekt të jetës së përditshme të qytetarëve. MSA është themel i procesit të integritit evropian.

Studimi përbëhet nga dokumenti kryesor dhe dy shtojca:

- (1) afatet ligjore të MSA-së;
- (2) afatet e liberalizimit të tregut në mes Kosovës dhe BE-së.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Bazuar në MSA, palët – Kosova dhe BE-ja, kanë ndërmarrë detyrime të ndërsjella për të realizuar në mënyrë progresive dhe të plotë asocimin brenda një periudhe dhjetëvjeçare.

Obligimet e Kosovës që rrjedhin nga MSA mund të ndahen në dy kategori:

1. Detyrimet e përgjithshme të Kosovës për t'u angazhuar në dialog progresiv politik dhe për të zbatuar rregullat e BE-së në të gjitha kapitujt e acquis;
2. Detyrimet specifike të Kosovës, të cilat duhet të përmbushen brenda periudhës së caktuar kohore.

Në kuadër të këtij studimi neve kemi vendosur të përqendrohemi në kategorinë e dytë të detyrimeve.

Në kuadër studimit do të gjeni se kemi vendosur të prezantojmë detyrimet e Kosovës nga MSA-ja në renditje kronologjike, apo viteve se kur do hyn në fuqi detyrimi specifik. Ne jemi të mendimit se kjo qasje do të ishte më praktike për lexuesit tanë.

Kapitujt e studimit janë të organizuar sipas viteve kur detyrimi specifik hyn në fuqi.

Detyrimet janë të paraqitura në pjesën kryesore të faqes, ndërsa në anën e djathtë të secilës faqe kemi indikuar titullin dhe kapitullin përkatës të MSA-së.

2016

Me hyrjen në fuqi të MSA-së, një numër të detyrimeve kanë hyrë në fuqi.

Në kuadër të titullit IV, kapitulli II, lëvizja e lirë e mallrave, Kosova dhe BE shfuqizuan tarifatat doganore, kufizimet sasiore dhe masat që kanë efekt të njëjtë në importet e produkteve industriale, bujqësore dhe të peshkut.

Marrëveshja ka paraparë “standstill” – dispozitë e cila ndaloj futjen e çfarëdo tarife të re doganore, kufizimet sasiore mbi importet ose eksportet ose tarifatat që kanë efekt të njëjtë në tregtinë midis BE-së dhe Kosovës.

Në kuadër të titullit IV, kapitulli III, mbi monopolin shtetëror me karakter komercial, Kosova ndërmori për të siguruar që, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, nuk do ekzistoj asnjë diskriminim lidhur me kushtet në të cilat mallrat blihen dhe tregtohen midis shtetasve të Shteteve Anëtare dhe qytetarëve të Kosovës.

Titulli IV, kapitulli II, lëvizja e lirë e mallrave

Titulli IV, kapitulli III, monopoli shtetëror me karakter komercial

2016

Në kuadër të titullit V, kapitulli I për të drejtën e themelimit, Kosova dhe BE u zotuan t'i ofrojnë njëra-tjetrës:

(1) Themelimin e ndërmarrjeve në territorin e palës tjetër dhe trajtim jo më pak i favorshëm se ai i akorduar ndërmarrjeve të veta ose ndonjë ndërmarrjeje të vendi të tretë, cilado që është më e favorshme; dhe

(2) Operimi i filialeve dhe i degëve të ndërmarrjeve në territorin e palëve, dhe trajtim jo më pak i favorshëm se ai i akorduar ndërmarrjeve të veta ose ndonjë ndërmarrjeje të vendi të tretë, cilado që është më e favorshme.

Po ashtu, Kosova ndërmori për të siguruar që filialet dhe degët e ndërmarrjeve të BE-së do të kenë, nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, të drejtën e përdorimit dhe të marrjes me qira të pronës së paluajtshme në Kosovë.

Titulli V, kapitulli I, e drejta e themelimit

2016

Ngjashëm sikur në rastin e lëvizjes së lirë të mallrave, në kuadër të titullit V, kapitulli II, për ofrimin e shërbimeve ndërmjet palëve – ka hyrë në fuqi dispozita “standstill” e cila cili ndaloj ndërmarrjen e masave apo veprimeve të cilat krijojnë kushte më të pafavorshme, në krahasim me situatën ekzistuese në ditën para ditës së hyrjes në fuqi të MSA-së, për ofrimin e shërbimeve nga shtetasit ose ndërmarrjet e BE-së dhe qytetarë ose ndërmarrjet e Kosovës që kanë vendin e tyre të qëndrimit të përhershëm ose e themelimit në një palë tjetër nga ajo e personit për të cilin shërbimet janë të destinuara.

Në kuadër të titullit V, kapitulli III për trafikun transit, palët janë dakorduar që të sigurojnë qasje të pakufizuar në trafikun transit të BE-së përmes Kosovës dhe në trafikun transit të Kosovës përmes BE-së me efekt nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

Titulli V, kapitulli II, ofrimi i shërbimeve

Titulli V, kapitulli III, trafiku transit

2016

Në kuadër të titullit V, kapitulli IV për lëvizjen e kapitalit, dhe në lidhje me transaksionet në llogarinë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave, nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit në lidhje me investimet direkte të bëra në ndërmarrjet e themeluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe investimet e bëra në përputhje me kapitullin I të titullit V, dhe likuidimin ose riatdhesimin e këtyre investimeve dhe të çdo fitimi që rrjedh prej tyre.

Po ashtu, nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit në lidhje me kreditë që lidhen me transaksionet tregtare ose me ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë huatë dhe kreditë financiare, në të cilat një rezident i një prej palëve është pjesëmarrës. Ky nen nuk mbulon investimet e portofolit, veçanërisht blerjen e aksioneve në tregun e kapitalit vetëm me qëllim të bërjes së një investimi financiar pa ndonjë qëllim për të ndikuar në menaxhimin dhe kontrollin e ndërmarrjes.

Titulli V, kapitulli IV, lëvizja e lirë e kapitalit

2016

Në kuadër të titullit VI për konkurrencën dhe dispozitat e tjera ekonomike, gjatë pesë viteve të para pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, çdo ndihmë shtetërore e dhënë nga Kosova vlerësohet duke marrë parasysh faktin se Kosova konsiderohet si një zonë identike me ato zona të BE-së të përshkruar në nenin 107 (3) (a) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

Në lidhje me aspektet tregtare të pronësisë intelektuale dhe njohjen dhe mbrojtjen e pronës intelektuale, industriale dhe tregtare, nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, palët i kanë ofruar shtetasve dhe ndërmarrjeve të palëve, trajtim jo më pak të favorshme sesa trajtimi që ju ofrohet tyre nga ndonjë vend të tretë sipas marrëveshjeve bilaterale.

Titulli VI, konkurrenca dhe dispozitat e tjera ekonomike

2016

Ndërsa në prokurimin publik, nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, ndërmarrjet e Kosovës, qoftë të themeluara në BE apo jo, do të kenë qasje në procedurat e shpërblimit me kontratë në BE sipas rregullave të prokurimit të BE-së nën trajtim jo më pak të favorshëm sesa ato të akorduara ndërmarrjeve të BE-së.

Trajtimi i njëjtë aplikohet edhe për kompanitë e BE-së, të themeluara apo jo në Kosovë, në lidhje me procedurat e shpërblimit me kontratë në Kosovë.

Titulli VI, konkurrenca dhe dispozitat e tjera ekonomike

2017

Në kuadër të titullit V, kapitulli IV për lëvizjen e kapitalit, gjatë vitit të parë pas datës së hyrjes në fuqi të marrëveshjes, Kosova do të marrë masa që lejoj krijimin e kushteve të nevojshme për aplikimin e mëtejshëm gradual të rregullave të BE mbi lëvizja e lirë e kapitalit.

Titulli V, kapitulli IV, lëvizja e lirë e kapitalit

2018

Në kuadër të titullit III për bashkëpunimin rajonal, brenda dy vjetëve pas hyrjes në fuqi Kosova duhet, nëse rrethanat objektive lejojnë, të filloj negociatat me vendet që kanë nënshkruar tashmë Marrëveshjet Stabilizimi Asocimi me BE-në me qëllim të lidhjes së konventave dypalëshe për bashkëpunim rajonal.

Në kuadër të titullit V, kapitulli II për ofrimin e shërbimeve, Këshilli i Stabilizim Asociimit brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, është dashur të shqyrtoj dhe të ndërmer hapa të domosdoshëm për njohjen reciproke të kualifikimeve, me qëllim që të lehtësoj për qytetarët e Kosovës dhe BE-së të ndjekin aktivitetet e rregulluara profesionale në Kosovë dhe BE.

Titulli III, bashkëpunimi rajonal

Titulli V, kapitulli II, ofrimi i shërbimeve

2018

Në kuadër të titullit V, kapitulli IV për lëvizjen e kapitalit, deri në fund të vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, Këshilli i Stabilizim Asociimit është dashur të përcaktojë modalitetet për aplikimin e plotë të rregullave të BE-së të lidhur me lëvizjen e lirë të kapitalit në Kosovë.

Titulli V, kapitulli IV, lëvizja e lirë e kapitalit

2019

Në kuadër të titullit IV, kapitulli II për bujqësinë dhe peshkimin, duke marrë parasysh vëllimin e tregtisë së produkteve bujqësore dhe peshkut midis palëve, të ndjeshmërisë së tyre, të rregullave të politikave të përbashkëta të BE-së dhe të politikave për bujqësinë dhe peshkimin në Kosovë, roli i bujqësisë dhe peshkimit në ekonominë e Kosovës, si dhe zhvillimet në kuadër të OBT-së, Këshilli i Stabilizim Asociimit, jo më vonë se tre vjet pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, do të shqyrtojë mundësitë për dhënien e koncesioneve të mëtejshme mes palëve me qëllim të zbatimit të mëtutjeshëm të liberalizimit të tregtisë të produkteve bujqësore dhe peshkut.

Titulli IV, kapitulli II, bujqësia dhe peshkimi

2019

Në kuadër të titullit VI mbi konkurrencën dhe dispozitat e tjera ekonomike, Kosova do të krijojë një regjistër të skemave të ndihmës shtetërore dhe do të harmonizojë skemat e tilla të ndihmës shtetërore me rregullat e BE-së brenda një periudhe jo më të vonshme se tre vjet nga hyrja në fuqi e marrëveshjes.

Po ashtu, deri në fund të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, Kosova do të aplikoj ndaj ndërmarrjeve publike dhe ndërmarrjeve të cilave iu janë dhënë të drejta të veçanta dhe ekskluzive, parimet e përcaktuara në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, duke iu referuar veçanërisht nenit 106 të tij.

Titulli VI, konkurrenca dhe dispozitat e tjera ekonomike

2020

Në kuadër të titullit VI për konkurrencën dhe dispozitat e tjera ekonomike, brenda katër viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, Kosova do t'i dorëzojë Komisionit Evropian të dhënat BPV-së për kokë banori të harmonizuara në nivelin NUTS II.

Në kuadër të titullit VII për migrimin ligjor, brenda një periudhe prej katër vjetësh pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, Kosova do të ofroj shtetasve të BE-së të drejtat që kanë të bëjnë me migrimin legal.

Titulli VI, konkurrenca dhe dispozitat e tjera ekonomike

Titulli VII, migrimi ligjor

2021

Në kuadër të titullit I për parimet e përgjithshme, jo më vonë se viti i pestë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, Këshilli i Stabilizim Asociimit duhet të bëjë vlerësim të plotë të zbatimit të marrëveshjes.

Në kuadër të titullit IV, kapitulli II për bujqësinë dhe peshkimin, Kosova do të sigurojë që mallrat e eksportuara nga territori i saj pesë vjet pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes nuk shkelin treguesit gjeografikë të BE-së të regjistruar në BE sipas Rregullores (BE) Nr. 1151 / 2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 21 nëntor 2012, mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore.

Titulli I, parimet e përgjithshme

Titulli IV, kapitulli II, bujqësia dhe peshkimi

2021

Në kuadër të titullit V, kapitulli I për themelimin, brenda pesë vjetësh nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, filialet dhe degët e ndërmarrjeve të BE-së do të kanë të drejtë të fitojnë dhe gëzojnë të drejtat pronësore mbi pronën e paluajtshme si ndërmarrjet e Kosovës, ndërsa sa i përket mallrave publike / mallrat me interes të përbashkët, të njëjtat të drejta që gëzojnë ndërmarrjet e Kosovës përkatësisht kur këto të drejta janë të nevojshme për ushtrimin e aktiviteteve ekonomike për të cilat ato ndërmarrjet e BE-së janë themeluar.

Në kuadër të titullit V, kapitulli II për ofrimin e shërbimeve, Këshilli i Stabilizim Asociimit, pesë vjet pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, do të merr masat e nevojshme për të zbatuar në mënyrë progresive të drejtën për ofrimin e shërbimeve nga shtetasit dhe ndërmarrjet e palëve të cilat janë vendosur në territorin e një pale tjetër nga ajo e personit për të cilin shërbimet janë destinuar.

Titulli V, kapitulli I, e drejta e themelimit

Titulli V, kapitulli II, ofrimi i shërbimeve

2021

Në kuadër të titullit V, kapitulli IV për lëvizjen lirë e të kapitalit, Kosova brenda pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, do t'u garantoj shtetasve të BE-së trajtim të barabartë lidhur me fitimin e pasurisë së paluajtshme në territorin e saj.

Në kuadër të titullit VI për aspektet e përgjithshme të pronësisë intelektuale, Kosova do të merr masat e nevojshme për të garantuar jo më vonë se pesë vjet pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes një nivel mbrojtjeje të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe komerciale të ngjashme me ato në BE, duke përfshirë mjetet efektive të zbatimit të këtyre të drejtave.

Titulli V, kapitulli IV, lëvizja e lirë e kapitalit

Titulli VI, aspektet e përgjithshme të pronësisë intelektuale

2021

Ndërsa, lidhur me prokurimin publik brenda pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, Kosova do të miratojë legjislacionin për prokurimin publik për të zbatuar standardet procedurale të parashikuara me acquis.

Në kuadër të titullit VIII për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, Kosova do të miratojë legjislacionin e BE-së pesë vjet pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Titulli VI, prokurimi publik

Titullit VIII, rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike

2022

Në kuadër të titullit V, kapitulli II për ofrimin e shërbimeve, gjashtë vjet nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, Këshilli i Stabilizim Asociimit do të përcaktoj modalitetet për zgjerimin e dispozitave të MSA-së për ofrimin e shërbimeve për shtetasit e BE-së dhe qytetarët e Kosovës me qëllim të garantimit të hyrjes dhe qëndrimit të përkohshëm të ofrueseve të shërbimit të regjistruar si të vetëpunësuar në territorin e një pale dhe të cilët kanë lidhur një kontratë bona fide për të ofruar shërbime konsumatorit final në territorin e asaj pale, shërbimi i cili kërkon praninë e tyre të përkohshme në vendin e palës, me qëllim të përmbushjes së kontratës për ofrimin e shërbimeve.

Titulli V, kapitulli II, ofrimi i shërbimeve

2026

Në kuadër të titullit I për parimet e përgjithshme, asocimi do të realizohet në mënyrë progresive dhe të plotës brenda një periudhë dhjetëvjeçare.

Ndërsa, jo më vonë se viti i dhjetë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, Këshilli i Stabilizim Asociimit duhet të bëjë vlerësim të plotë të zbatimit të marrëveshjes.

Në kuadër të titullit IV për lëvizjen e lirë të mallrave, BE-ja dhe Kosova gradualisht do të krijojnë një zonë bilaterale të tregtisë së lirë në një periudhë prej 10 vjetësh duke filluar nga hyrja në fuqi e marrëveshjes në përputhje me marrëveshjen, GATT 1994 dhe dispozitat e përmbajtura në marrëveshjet përkatëse të OBT-së.

Titulli I, parimet e përgjithshme

Titulli IV, lëvizja e lirë e mallrave

ASISTENCA FINANCIARE PËR MSA

MSA në preambulën e saj ka nënvizuar gatishmërinë e BE-së për të ofruar mbështetje për zbatimin e reformave dhe për të përdorur të gjitha instrumentet e bashkëpunimit, asistencën teknike, financiare dhe ekonomike në kuadër të këtij qëllimi.

Po ashtu, titulli IX për bashkëpunimin financiar krijoi bazën ligjore për të mbështetur objektivat e MSA-së dhe ka ofruar bazën ligjore brenda së cilës Kosova pranon ndihmën financiare nga BE-ja në formën e granteve dhe kredive, duke përfshirë huatë nga Banka Evropiane e Investimeve.

Megjithatë, asistenca financiare e BE-së është e kushtëzuar me përparimin e mëtejshëm në përmbushjen e kriterëve politike të Kopenhagës. Po ashtu, BE-ja merr parasysh edhe përmbushjen e detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje nga ana e Kosovës, si dhe vlerësimet në kuadër të raporteve vjetore për Kosovën.

Titulli IX, bashkëpunimi financiar

ASISTENCA FINANCIARE PËR MSA

Ndihma financiare e BE-së gjithashtu i nënshtrohet kushteve të procesit Stabilizim Asocimi, veçanërisht në lidhje me ndërmarrjen e reformave demokratike, ekonomike dhe institucionale.

Asistenca financiare që i jepet Kosovës i përshtatet nevojave të saja, prioriteteve të dakorduara, aftësisë për të absorbuar asistencën, si dhe masave të marra për të reformuar dhe ristrukturuar ekonominë.

Asistenca financiare në formë të granteve ofrohet në përputhje me rregulloret përkatëse të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit brenda kornizës indikative shumëvjeçare dhe në bazë të programeve vjetore ose shumëvjeçare të përcaktuara nga BE-ja pas konsultimeve me Kosovën.

Titulli IX, bashkëpunimi financiar

ASISTENCA FINANCIARE PËR MSA

Në këtë kontekst, Dokumenti Strategjik Indikativ përcakton prioritetet për ndihmën financiare të BE-së për periudhën 2014-2020 me qëllim të mbështetjes së Kosovës në rrugën e saj evropiane.

Dokumenti kanalizon prioritetet politike të përcaktuara në kuadrin e politikës së zgjerimit, dhe në veçanti MSA-së, në fushat kyçe ku ndihma financiare është më e dobishme.

Alokimi indikativ për Kosovën në periudhën 2014-2020 është rreth €602 milionë.


Që nga hyrja në fuqi e MSA-së, në vitin 2016, asistenca e IPA-s për Kosovën është rritur në mënyrë eksponenciale, nga €222.71 milion (2014-2016) në €379.46 milion (2017-2020).

Prioritetet kryesore të financimit janë:

- Demokracia dhe qeverisja
- Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore
- Mjedisi, ndryshimet klimatike dhe energjia
- Konkurrenca, inovacioni, bujqësia dhe zhvillimi rural
- Arsimi, punësimi dhe politikat sociale

ASISTENCA FINANCIARE PËR MSA

IPA: para dhe pas MSA-së



ASISTENCA FINANCIARE PËR MSA

DEMOKRACIA DHE
QEVERISJA

100

MILION

SUNDIMI I LIGJIT DHE TË
DREJTAT THEMELORE

43

MILION

MJEDISI, NDRYSHIMET
KLIMATIKE DHE ENERGJIA

105

MILION

KONKURRENCA,
INOVACIONI, BUJQËSIA

78

MILION

ARSIMI, PUNËSIMI

54

MILION

TOTAL

380

MILION

INSTITUTI I KOSOVËS PËR POLITIKAT EVROPIANE, 2019.
TE GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.

